



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA HIMARË**

**NJËSIA E HARTIMIT TË DOKUMENTAVE TË TENDERIT**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Himarë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2026

### **PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS-PUNË**

#### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT: “Ndërtimi i varrezave të reja Dhërmi”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45215400-1 Punime ndërtimi për varreza**

**VLERA E FONDIT: 53,749,636.13** (Pesëdhjetë e tre milionë e shtatëqind e dyzet e nëntë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë presje trembëdhjetë) **pa TVSH**

**Perlllogaritja e fondit limit** dhe specifikimeve teknike është kryer nga inxhinier i licensuar referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj”, Inxhinieri është mbështetur ne manualin teknik te çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre bazuar ne ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. - VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve” - Udhëzimi nr.2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë e matshme dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Himarë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

##### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

**Argumentimi:**Ky kriter u vendos me mbështetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave

te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

*Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.*

*Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:*

*a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlloragatur të kontratës;*

*b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik*

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale**

Sipas kritereve të përgjithshme të pranimit / kualifikimit (shtojca 7)

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023, 2024, dhe 2025** lëshuar nga administrata tatimore , ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantojme qe operatoret ekonomike kane kapacitetin e nevojshem ekonomik dhe financiar per te zbatuar kontraten”, ”Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”, si dhe bazuar ne nenin 43, pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”: Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”. Vendosja e ketij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se

50 % e vlerës së përlogaritur/ fondit limit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2023**, **2024**, dhe **2025**, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit*

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43,pika 3,të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke pasur parasysh qe lloji i procedures eshte “e hapur”, percaktimi i vleres se kerkuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 2, germa “b” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku percaktohet se: “Vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar eshte ne nenin 43, pika 1” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku percaktohet se: ”Autoriteti/entikontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontrates.

2.2.3Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **2025** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar,

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB-së.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”,

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dheneni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **40 %** e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;  
**ose**
- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se **dyfishin** e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

### **Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

Për plotësimin e këtyre kriterëve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Në rast se punimet janë kryer me ente publike: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:
  - i. Kontratën e Sipërmarrjes,
  - ii. Situacionin përfundimtar të objektit
  - iii. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor
  - iv. Aktin e Kolaudimit të objektit
  - v. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9
  - vi. Në rast se kontrata e ngjashme është lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkëpunimit midis tyre.
  
- b) Në rast se punimet janë kryer në sektorin privat: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:
  - i. Kontratën e Sipërmarrjes,
  - ii. Situacionin përfundimtar të objektit
  - iii. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor
  - iv. Aktin e Kolaudimit të objektit
  - v. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9

*Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e*

*pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 40 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo me te vogel se dyfishi i vlerës limit të objektit të prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në liçensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Liçensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

▪ **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në liçensë:**

- **N.P-1 A** - Punime gërmimi në tokë.
- **N.P-4 C** - Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale.
- **N.P-11 A** - Ndërtime për nënstatcionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
- **N.S-6 A** - Sinjalistika rrugore jodriçuese.
- **N.S-18 A** - Punime topogjeodezike.

\* *Për Operatorët e huaj të bëhet njehësimi i liçensës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit në plotësimin e liçensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

\* Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, Liçensat profesionale duhet t’i paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Liçensa Profesionale.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008, ”Per miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, gjithashtu të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”,neni 8 përcakton "Zbatimi I punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, private ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuara	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1	Punime gjërmimi në tokë.	Punime gjërmimi dheu, Punime prishje, Punime gjërmimi shkëmbi i fortësive të ndryshme me ekskavator	A	0-21 milion
NP-4	Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale	Shtresa rrugore dhe punime të tipologjise së rrugëve dytësore dhe/ose linja të punimeve	C	51-100 milion
NP-11	Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë	Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshëm për shpërndarjen e T/N dhe tensionit të ulët deri te përdoruesit e energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit.	A	0-21 milion
NS -6	Sinjalistika rrugore jodriçuese	Sinjalistike rrugore jiondriçuese	A	0-21 milion
NS-18	Punime topogjeodezike	Punime topogjeodezike	A	0-21 milion

### 2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat ISO, si më poshtë:

- **ISO 9001:2015** (Sistem i Menaxhimit të Cilësisë)
- **ISO 14001:2015** (Sistem i Menaxhimit Mjedisor)
- **ISO 45001:2018** (Sistem i Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në punë)

- **ISO 5001-2018** (*Çertifikatën e menaxhimit te energjise*)

Nese certifikatat jane ne gjuhe te huaj, ato te paraqiten te perkthyer dhe te noterizuara ne gjuhen zyrtare shqipe. Keto certifikata te jene leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise. Certifikatat duhet te jene te vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet te dorezoje certifikatat e mesiperme sipas natyres se punimeve

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, si dhe nenit nr. 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe bazuar ne nenin 44 pika 1, e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 i ndryshuar. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, te ndryshuar, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Duke qenë se përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi është Autoriteti Kontraktor, gëzon të drejtën për t’u garantuar se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për punët që do të kryhen, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar”.

- Për ISO 9001 - 2015; Kjo çertifikate specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë, ku një operator ekonomik duhet të tregojë aftësinë e tij që vazhdimisht të sigurojë punë/mallra ose shërbime që plotësojnë kërkesat e aplikueshme ligjore dhe rregullatore, si dhe synon të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit duke përfshirë edhe proceset për përmirësim të vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit të klientit dhe kushtet e aplikueshme ligjore dhe rregullatore si dhe meqënëse Bashkia Himarë si Autoritet Kontraktor kërkon që punimet që do të kyhen të jenë në cilësinë më të lartë është përcaktuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me këtë standart cilësie.

- Per ISO 14001 – 2015: Eshtë kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standartin ISO 14001 – 2015, standart ky që vlerëson sipas përkufizimit të tij përgjegjshmërinë e kompanive ndaj mjedisit. Standardet e Sistemit të Menaxhimit - që vlerësojnë nivelin e sistemit të zhvillimit dhe integritit të përgjegjësive ndaj mjedisit në të gjithë kompaninë. Bashkia Himarë si Autoritet Kontraktor kërkon një manaxhim të aktivitetit përkushtuar parandalimit të ndotjes dhe të përmirësimit të ndikimeve mjedisore.

- Per ISO 45001:2018: Eshtë kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standartin ISO 45001:2018, standart ky që përcakton kërkesat minimale të shëndetit në punë dhe praktikat më të mira të menaxhimit të sigurisë. Ky lloj standarti konsiston në sigurimin e një sistemi shëndetësor optimal dhe menaxhimin e sigurisë në punë. Kjo mund te ndihmojë per të vënë në

vend politikat, procedurat dhe kontrollet e nevojshme për cdo lloj biznesi për të arritur kushtet më të mira të mundshme të punës, një linjë me praktikën më të mirë të njohur ndërkombëtare

- ISO 50001:2018 është një standard ndërkombëtar që fokusohet në sistemet e menaxhimit të energjisë. Ai ndihmon organizatat të rrisin efikasitetin e përdorimit të energjisë, të reduktojnë kostot dhe të minimizojnë ndikimin mjedisor. ISO 50001 është një mjet i dobishëm për çdo organizatë që të menaxhojë më mirë energjinë dhe të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **35 (tridhjetë e pesë) punonjës**, me kohë të plotë pune, për periudhën **3 (tre) muajt** e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Staf i menaxherial i Drejtuesve Teknik. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
2. Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

**Argumentimi :** Kriteri i vendosur për disponimin e numrit minimal prej **35 (tridhjetë e pesë) punonjës**, për të paktën 3 muajt e fundit, me kohë të plotë pune, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-së dhe nenit 39 pika 6/c, ku numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve, njësia e prokurimit ka marrë parasysh numrin e punonjësve që nevojitet për realizimin e objektit dhe afatin e kryerjes së punimeve të përcaktuar në dokumentet e tenderit, , ku në zbatim të nenit 77 pika 5 të LPP-së dhe legjislacionit tatimor, janë përcaktuar dokumentet konkrete që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për përmbushjen e këtyre kushteve. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve përfshihen punonjësit inxhinierë, specialistë, punonjës të kualifikuar dhe punëtorë për punime me krahë, drejtuesit e mjeteve të thjeshta apo të rënda etj., duke pasur parasysh njëkohësisht volumin e punimeve. Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*. Përlllogaritja e numrit total të punonjësve është bërë në bazë të manualit teknik të punimeve si më poshtë:

**2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe çertifikimet përkatëse, si më poshtë:**

a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në liçencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë noteriale pune (të vlefshme), diplomë përkatëse, CV, librezë pune, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6, stafi inxhinierik si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi profili Gjeoteknike
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik;
- 1 (një) Inxhinier Elektrik;
- 1 (një) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder;
- 1 (një) Inxhinier Gjeolog;
- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

**Argumentimi :** Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 6 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike e profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.” Kërkesa për 1 (një) punonjës Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në

punë mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Operatori/ët ekonomik/ë, që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatëse lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010.Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

**Konkretisht:** Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet me objektin e kontratës dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës, me qëllimin për të pasur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. **Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.**

- **1 (një) Inxhinier Ndërtimi profili Gjeoteknikë** – i nevojshëm për vlerësimin e kushteve gjeoteknike të terrenit, analizën e qëndrueshmërisë së dherave, shpateve dhe themeleve, si dhe për përcaktimin e zgjidhjeve të sigurt konstruktive.
- **1 (një) Inxhinier Elektrik** – i domosdoshëm për instalimet elektrike, furnizimin me energji, ndriçimin dhe garantimin e sigurisë teknike të sistemeve elektrike në objekt.
- **1 (një) Inxhinier Hidroteknik** – i nevojshëm për të garantuar zbatimin korrekt të punimeve që lidhen me menaxhimin dhe largimin e ujërave (drenazhime, kanale, tombino, kolektorë), duke siguruar mbrojtjen dhe funksionimin e qëndrueshëm të veprës ndërtimore.
- **1 (një) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder** – i domosdoshëm për rilevimet topografike, matjet në terren, piketimet, kontrollin gjeodezik dhe saktësinë e zbatimit të projektit sipas koordinatave teknike.
- **1 (një) Inxhinier Gjeolog** – i nevojshëm për studimin e formacioneve gjeologjike, identifikimin e risqeve natyrore, qëndrueshmërinë e terrenit dhe përshtatshmërinë e zonës për ndërhyrje.
- **1 (një) Inxhinier Ndërtimi** – i domosdoshëm për të drejtuar dhe mbikëqyrur zbatimin e punimeve ndërtimore, duke garantuar që ato të realizohen sipas projektit, specifikimeve teknike, standardeve të cilësisë dhe kërkesave të sigurisë.

Nga shoqëria kërkohet dhe një azhornim i saktë i këtij investimi në përfundim.

b) Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar për kryerjen e punimeve sipas zerave të preventivit të punimeve, si më poshtë:

- 1 (një) Teknik Ndërtimi
- 1 (një) Punonjës hidraulik
- 1 (një) Punonjës betonues
- 3 (tre) Punonjës karpentier
- 3 (tre) Punonjës hekurkthyes
- 2 (dy) Punonjës elektrikist
- 1 (një) Punonjës saldator

Per punojesit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale (të vlefshme).
- Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, i ndryshuar.
- Te gjithë punojësit e mësipërm duhet të figurojnë në listepagesat të shoqërisë minimalisht për periudhën tre muajt e fundit.
- Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punojesit e mesiperm, emer/mbiemer, profili i punës, numri dhe datë e kontratës individuale të punës, numrin e amazes dhe titullin e kualifikimit për diplomën/certifikatën përkatëse si dhe emrin e institucionit që ka lëshuar dokumentin për specialistet e kualifikuar me siper.

*Diplomat/certifikatat e paraqitura nga organizma të cilat nuk janë të licencuara sipas legjislacionit në fuqi do të konsiderohen si dokumenta të rreme të cilat përbëjnë shkak për skualifikim dhe/ose përjashtimin nga pjesëmarrja në prokurimet publike.*

\*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas deklarata B.

*Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do i kërkojë ofertuesit i kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentacionit të mëposhtëm:*

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është bazuar në paragrafin 3 të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, specififikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Numri është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

## Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **1 (një) Teknik Ndërtimi** – i nevojshëm për organizimin e punimeve në terren, ndjekjen e proceseve të zbatimit, koordinimin e fuqisë punëtore dhe asistimin teknik ndaj stafit inxhinierik.
- **1 (një) Punonjës hidraulik** – i domosdoshëm për instalimin, mirëmbajtjen dhe testimin e rrjeteve hidraulike, tubacioneve, sistemeve të furnizimit me ujë, drenazhimit dhe kanalizimeve.
- **1 (një) Punonjës betonues** – i nevojshëm për përgatitjen, hedhjen, nivelimin dhe trajtimin e betonit në elementët konstruktivë, duke garantuar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e punimeve.
- **3 (tre) Punonjës karpentier** – të nevojshëm për realizimin e kallëpeve, strukturave ndihmëse prej druri ose materiale të tjera, si dhe për montimet e nevojshme gjatë fazave të ndërtimit.
- **3 (tre) Punonjës hekurkthyes** – të domosdoshëm për përpunimin, prerjen, lakimin dhe vendosjen e armaturës metalike në elementët e betonarmës sipas projektit teknik.
- **2 (dy) Punonjës elektrikist** – të nevojshëm për instalimet elektrike, lidhjet energjetike, montimin e pajisjeve elektrike dhe garantimin e funksionimit të sigurt të sistemeve.
- **1 (një) Punonjës saldator** – i domosdoshëm për bashkimin e elementëve metalikë, riparimet strukturore dhe realizimin e punimeve që kërkojnë saldim profesional.

Kërkesat e mësipërme bazohen në pikën 4 Nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” neni 39 pika 6/c të VKM nr. 285 dt. 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku kërkohet që OE të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar, si dhe bazuar në rregullore “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre” miratuar me urdhrin nr. 200 dt. 16. 05. 2019 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjitikës.

- a) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar në liçencë **1 (një)** Punonjës të certifikuar si “*Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë*” gjatë kryerjes së veprimtarisë , në përputhje me klauzolat e ligjit Nr.10431 datë 09/06/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” i cili duhet të figurojë në listëpagesa të shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6, ku për përmbushjen e këtij kushti operatori ekonomik ofertues duhet ta deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin: kontratë të vlefshme pune, dhe dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi nga një organizëm i akredituar/licencuar /certifikuar shqiptar ose i huaj.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat

minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

- b) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë **1 (një)** punonjes i pajisur me certifikatë “**Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave**” e cila të jetë e lëshuar nga shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/Certifikatë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

*(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave").*

Kërkesa për disponimin e **1 (një) punonjësi të pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”** është e nevojshme për garantimin e sigurisë dhe menaxhimit të situatave emergjente gjatë realizimit të kontratës, duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve dhe risqet që paraqiten në kantier apo gjatë ushtrimit të aktivitetit.

Konkretisht:

- Ky punonjës siguron **reagim të menjëhershëm në rast aksidentesh në punë**, dëmtime fizike, lëndime apo situata të papritura që mund të ndodhin gjatë procesit të zbatimit.
- Disponimi i një specialisti të trajnuar në ndihmën e parë ndihmon në **minimizimin e pasojave shëndetësore** deri në mbërritjen e shërbimeve mjekësore emergjente.
- Punonjësi i certifikuar garanton **zbatimin e procedurave të evakuimit, menaxhimit të emergjencave dhe masave parandaluese**, në përputhje me standardet e sigurisë në punë.
- Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me detyrimin e operatorit ekonomik për të siguruar **mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të punonjësve**, si dhe për të krijuar kushte të sigurta pune gjatë gjithë periudhës së kontratës.
- Kërkimi që certifikata të jetë e lëshuar nga subjekte të akredituara ose organizma të njohur garanton **vlefshmërinë profesionale dhe standardin e trajnimit** të punonjësit.
- Kërkesa që punonjësi të figurojë në listëpagesa dhe të ketë kontratë pune të vlefshme synon të provojë se operatori ekonomik e ka realisht në dispozicion këtë kapacitet njerëzor dhe nuk e paraqet vetëm formalisht për qëllime kualifikimi.

- c) Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë *(nga Administratori i shoqërisë)* Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë, dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, *ku në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, për drejtuesin teknik të deklaruar, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Librezë pune (përkatëse)
  - CV përkatëse
  - Kontratë noteriale pune e vlefshme (përkatëse)
  - Diplomë
- Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik në bashkim, duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë, Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të

jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

**Argumentimi :** Kërkesat e mësipërme janë vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin Teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin Teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Në Kreun IV të VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 1 “Drejtuesi teknik i shoqërisë”, gërma b) parashikohet: “Licenca profesionale e shoqërisë kategorizohet mbështetur në diplomimin dhe përvojën personale të drejtuesit/drejtuesve teknikë, kërkesave të tjera që caktohen në këtë rregullore dhe vlerësimit të komisionit për dokumentacionin e paraqitur. Përcaktimi i kërkesës për Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt garanton autoritetin jo vetëm për angazhimin të kësaj kohe e kryerjes së punimeve të një drejtuesi teknik të shoqërisë por dhe si orientim për një person kontakti dhe urë lidhëse mes mbikqyresit të punimeve dhe AK për problematiken që do të haset gjatë realizimit të punimeve.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar minimumi: Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar minimumi:

- Manovratore/Eskavatoriste – jo më pak se **2 (dy)** punonjës
- Automakinist – jo më pak se **2 (dy)** punonjës
- Shofer – jo më pak se **5 (pesë)** punonjës
- Buldozerist – jo më pak se **2 (dy)** punonjës

, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesa të shoqërisë të punësuar për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6 në rastin kur mjetet/ makineritë e deklaruara janë në pronësi të operatorit ekonomik ofertues, në të kundërt kur mjetet/ makineritë disponohen me qera, ky staf i kërkuar mund të jetë i kontraktuar, **dhe në çdo rast, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin të paraqiten:**

Per punojesit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale të vlefshme.

- (Dëshmi te Aftësisë Profesionale), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe tokë, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin Nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës dhe referuar Kodit Rrugor, e cila duhet të perkoje me kerkesat e profilit të deklaruar për cdo punojës.
- Të figurojnë në listpagesat e E-Sig minimalisht për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave, ku punojësit e mësipër duhet të figurojnë të regjistruar sipas legjislacionit në fuqi.
- Gjate fazes së ofertimit në plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, pika B. Deklarata -“Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, operatorët ekonomik për punonjësit eskavatoriste, automakinist, shofer, duhet të deklarojnë: emer/mbiemer, profilin e punes, datën e kontrates së punes, numrin e dëshmisë së aftësisë profesionale dhe datën e vlefshmerisë së saj.

Kur mjetet janë marrë me qira nga persona fizik, të cilat janë në pronësi të këtyre të fundit, atehere eskavatorist / buldozeristet , automakinistet, dhe shoferet nuk ka nevojë që të figurojnë në listëpagesat përkatëse të O.E. ofertues.

Ne rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet të paraqesë punojësit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

AK rezervon të drejtën e verifikimit të deklarimeve për punojësit e mesiperm, cdo informacion i rreme apo i devijuar nga kerkesat e mesiperme do të jete kusht për skualifikimin e ofertes.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës., të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Manovratorët dhe shoferet janë të nevojshëm për shkak të makinerive të ndryshme që do të kryejnë punime gërmimi, ngjeshje materiali etj.

### 2.3.7 (Makineri, Pajisje)

a) **Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, automjetet, makineritë dhe pajisjet (sipas tabelës) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;**

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1	Eskavator me cekic 0.25 m <sup>3</sup>	copë	1	<i>Në pronësi ose me qera</i>
2	Eskavator me zinxhir	copë	1	<i>Në pronësi ose me qera</i>
3	Fadromë me goma	copë	1	<i>Në pronësi ose me qera</i>

4	Minieskavator	copë	1	<i>Në pronësi ose me qera</i>
5	Kamion me kapacitet mbi 10 ton	copë	5	<i>Në pronësi ose me qera</i>
6	Autopompë betoni	copë	1	<i>Në pronësi ose me qera</i>
7	Autobetoniere	copë	3	<i>Në pronësi ose me qera</i>
8	Kamioncin me kapacitet deri ne 3.5 ton	copë	3	<i>Në pronësi ose me qera</i>
9	Rul ( Kompresor me vibrim)	copë	2	<i>Në pronësi ose me qera</i>
10	Gjenerator	copë	1	<i>Në pronësi ose me qera</i>
11	Tokmak elektrik	cope	1	<i>Në pronësi ose me qera</i>
12	Depozita uji 5000 litra	copë	2	<i>Në pronësi ose me qera</i>
13	Betoniere	copë	3	<i>Në pronësi ose me qera</i>
14	Saldatriçe	copë	1	<i>Në pronësi ose me qera</i>

b) Gjithashtu në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:

Kokore + Jelekë fosforoshentë	min	35 copë
Fikëse zjarri të lëvizshme	min	15 copë
Prozhektorë ndriçimi natën	min	4 copë
Komplet i ndihmës së shpejtë	min	4 copë
Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt	mini	10 copë

□ **Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të mjeteve/ makinerive dhe pajisjeve të kërkuara më lart, në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqiten:**

- 1- **Për mjetet me goma që shënohen në rregjistra publike** duhet të paraqitet dokument që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.
- 2- **Për mjetet e siguruar me qira**, të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar plus dokumentat që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.

- 3- **Për pajisjet/ makineritë në pronësi** të shoqërohen me Akt - Pronësie original ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes/ makinerisë (*të paktën 1*).
- 4- **Për pajisjet/ makineritë me qera** të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie original ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes/ makinerisë (*të paktën 1*).

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik1” në të cilin përcaktohet: Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Në nenin 39 pika 6 d “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” pika 6/d të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon... mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”

Këto mjete dhe pajisje referuar preventivit të punimeve janë të nevojshme për realizimin e punimeve, ndaj njësia e prokurimit vendosi që të kërkojë që operatorët ekonomike të disponojnë mjetet dhe pajisjet e mësipërme sepse ato nevojiten për kryerjen e punimeve dhe janë në përpjesëtim me objektin e kontratës.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë bazuar sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjeti kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet kontratës së shitjes apo kontratës së qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci autoritetit kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të grafikut të punimeve. Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar Ligjvënësi i jep të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë nga ana e Operatorëve ekonomike dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike. Njësia e Prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatës në lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që Operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Çdo mjet i përcaktuar në procedurën e prokurimit është kërkuar në funksion të kryerjes së zërave specifike të punimeve, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varësi të volumeve të punimeve dhe kohës së realizimit të tyre. Përsa më sipër, numri i mjeteve është përcaktuar në bazë të nevojës pasi objekti zhvillohet në një kohë të shkurtër, pa cenuar grafikun e përcaktuar të punimeve dhe, veç të tjerash, Në lidhje me kriterin për disponimin e makinerive dhe pajisjeve, njësia e prokurimit vlerëson se referuar përmasave

dhe volumit të punimeve objekt kontrate, operatorëve ekonomike u lind e nevojshme disponimi i makineri pajisjeve.

Ndërsa mjetet dhe pajisjet të mbrojtjes në punë të punëtorëve, si dhe të personelit, janë kërkuar në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë: 05.05.2010 "Për miratimin e Rregullores për sigurinë në kantier". Njësia e prokurimit vlerëson se pa këto mjete një operator ekonomik nuk mund të realizojë punët e parashikuara në këtë objekt prokurimi. Ruajtja dhe siguria në punë të jetëve njerëzore, është përparësi dhe detyrim ndaj punonjësve.

**Shënim:** Makineritë dhe pajisjet, janë kërkuar në bazë të specifikës së punës, volumit dhe punimeve paralele në katër fronte me shtrirje të gjerë gjeografike, kjo sipas gjurmëve dhe zbatimit të projektit të miratuar për punimet në terren.

2.3.8 Operatorët ekonomikë, duhet të kenë **1 (një)** Impiantin e prodhimit të betoni, dhe duhet të paraqesë Raport Vetemonitorimi planvendosjen dhe projektin teknologjik. Për fabrikën e betonit duhet të paraqiten dokumentet e pronësive si akte çdoganimit ose fatura tatimore të blerjes. Në rastin e fabrikës/linjes me qera/kontrate furnizimi dokumentet e mesiperme duhet të shoqerohen me kontratën perkatese të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në këtë rast operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin ligjor që verëton pronësinë e tij (fatura tatimore/zhdoganimi ose kontrate shitblerjeje si dhe e shoqeruar me foto)

**Argumetimi teknik:** Impianti i prodhimit të betonit është i nevojshëm për furnizimin e veprave të artit në objekt. Duke pasur parasysh shtrirjen gjeografike të objektit, AK e konsideron të nevojshëm impiantin për arsye teknike dhe të zbatimit të projektit sipas specifikimeve teknike dhe realizimit sipas grafikut.

2.3.9 Operatorët ekonomikë, duhet të kenë **1 (një) Nyje Inerte**, e cila duhet të paraqesë Raport Vetemonitorimi planvendosjen dhe projektin teknologjik. Për Nyjen e materialeve inerte, në rast se është në pronësi duhet të paraqiten dokumente që verëtojnë pronësinë, Në rast se është me qera duhet të paraqitet kontrata noteriale e qerave, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rast se nuk ka në pronësi apo me qera Nyje të materialeve inerte duhet të paraqitet kontrata noteriale e furnizimit me prodhuesin, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës.

**Argumetimi teknik** : E nevojshme për furnizimin e kantierit me material inert si për shtresat rrugore ashtu edhe për zërat e tjera të punimeve në kantier dhe përgatitjen e betonit. Ajo duhet të plotësojë të gjitha standartet ligjore dhe teknike sipas legjislacionit në fuqi

**Argumentimi** Në bazë të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", me anë të këtij kriteri AK gjykon se disponimi në pronësi apo me qera i këtyre fabrikave është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kerkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i garantuar për ofrirnin tek Autoriteti Kontraktor të këtyre mallrave që do të perdoren në punimet e planifikuara. Kjo garanci lidhet njekohesisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave objekt prokurimi të cilat kerkohen që të jenë prodhuar në përputhje me standardet dhe cilësitë e kerkuara në DST. Ky kriter është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtperdrejt me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kerkese i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për

permbushjen me sukses te kontrates pasi sasia e produkteve qe do te perdoren eshte e konsiderueshme.

2.3.10 Operatoret ekonomike duhet te jene te pajisur me leje mjedisore kodi III.2.B per grumbullim dhe transportimin e mbetjeve objekt i kontratës, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit, së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.11 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar, preventivin si dhe analizen e cmimeve per zerat e preventivit, (Bashkëlidhur DST) në dokumentat e tenderit. Ne rast BOE grafikun e punimeve duhet te jete i firmosur dhe vulosur nga secili prej administratoreve perkates.

Autoriteti Kontraktor do te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimet e bera në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht s’kualifikimi.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **NJESIA E PROKURIMIT**